



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Nr. 233/12 prot

Date 07/05/2024

Lënda: **Dërgim Oponence Teknike**

BASHKISË DURRËS

Lagjja Nr.1, Sheshi "Liria", Durrës

Në vijim të kërkesës suaj me Nr.1821 prot, datë.06.02.2024, protokolluar me tonën me Nr.233 Prot, datë.08.02.2024, "**Kërkesë për kryerjen e Oponencës teknike**", po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të projekt zbatimit të objektit: "**Rikualifikim i Pallatit të Kulturës**", **Bashkia Durrës**.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Artan SHKRELI



OPONENCË TEKNIKE
PËR PROJEKTIN E ZBATIMIT TË OBJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI PALLATIT TË KULTURËS
ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

POROSITËS: BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE INFRASTRUKTURËS PUBLIKE

GRUPI I PROJEKTIMIT

PROJEKTI ARKITEKTONIK

Shoqëritë “ASARCHITECTS” sh.p.k. + Michele CRO ARCH.

- Ark. Antonela SALIAJ
- Ark. Ani TOLA(PANARITI)

PROJEKTI KONSTRUKTIV

- Ing. Alier CARA

Nr.Lic.K.1221/2

PROJEKTI ELEKTRIK

Shoqëria “ZAVALANI CONSULTING” sh.p.k.

- Ing. Orion ZAVALANI
- Ing. Ilir SHIMKO
- Ing. Gjergj DASHI

Nr.Lic.E.180/4

PROJEKTI HIDROSANITAR

- Ing. Alket KUMARAKU

PROJEKTI MEKANIK (HVAC)

- Ing. Artan DERSHA
- Ing. Albert SHIRA

Nr.Lic.M.0229/3

Nr.Lic.M.0629/4

PROJEKTI MBROJTJES NGA ZJARRIT

- Ing. Artan DERSHA

Nr.Lic. M0229/3-Cert. No. 2711

Bëhet kjo oponencë teknike për projektin e zbatimit të objektit: **“RIKONSTRUKSIONI PALLATIT TË KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS**, mbështetur në Ligjin Nr. 8402 dt.10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Neni 6; në V.K.M. Nr.9 dt.11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë , si dhe procedurat që duhet të ndiqen në këto raste”, në Urdhërin e Ministrit Nr.243 dt. 12.06.2019 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe në Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”



Grupit të oponencës i janë vënë në dispozicion këto materiale:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike, protokolluar me tonen me Nr.233 Prot., Datë. 08.02.2024.
- Marrëveshja midis **Bashkisë Durrës** dhe Institutit të Ndërtimit me Nr. 1821 prot, datë. 22.02.2024 dhe me Nr.233/1 Prot., date.20.02.2024 të Institutit të Ndërtimit, ku Tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është **325,228 (treqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë me TVSH.**
- Detyra e projektimit (termat e references)
- Planvendosje + Plansistemim
- Projekti Konstruktiv + Relacioni Teknik Konstruktiv
- Projekti Arkitektonik + Relacioni Arkitektonik
- Projekti Elektrik + Raport Teknik
- Projekt Hidrosanitare + Shënime teknike + Analizë cmimi
- Projekt i Impiantit të ajrit të kondicionuar + Relacion teknik Mekanik
- Projekti për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin + Relacioni Teknik mbi mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin
- Specifikime Teknike
- Preventivi I punimeve përmbledhëse dhe të vecanta(konstruktiv + elektrik + MNZ + HVAC + Hidrosanitar)
- Materialet kane ardhur ne menyre elektronike email

Mangësite ne dokumentacion:

- Licensat e shoqerise projektuese dhe grupit te projektimit
- Deklaratat e përgjegjësisë profesionale
- Policat e sigurimit
- Grafiku I punimeve

Materiali i dorëzuar, do të konsiderohet i mirëqenë dhe i saktë nga ana ligjore, absolutisht në përgjegjësi të dorëzuesit dhe do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit dhe hartimin e Oponencës Teknike.

1. TERMAT E REFERENCËS

Termat e referencës janë një material prej 18 fletesh hartuar nga Bashkia Durrës, firmosur nga grupi hartues.

Në këto terma reference jepet gjendja ekzistuese e Pallatit të Kulturës, historiku i saj, Objektivi dhe qëllimi i rikonstruksionit, kërkesat që duhet të zgjidhe projektuesi, standartet referuese, dokumentat që duhet të pregatiten nga kontraktori.

Konkluzion

Termat e referencës kanë kërkesa të qarta përsa i përket realizimit të një projekti teknik të rikonstruksionit të objektit.

2. PROJEKTI ARKITEKTONIK

Pranë grupit të oponecnës është paraqitur projekti arkitektonik për objektin: “RIKUALIFIKIMI I TEATRIT “ALEKSANDËR MOISIU”, në Durrës.

TË PËRGJITHSHME

Referuar Vendimit Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për Miratimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, Teatri “Aleksandër Moisiu” konsiderohet pjesë e hapësirës urbane arkeologjike, historike dhe kulturore të zonës “A”. Struktura shtrihet në një zonë të rendësishme të qytetit, në kryqezimin e rrugëve “Aleksander Goga” në perendim dhe “Grigor Durrsaku” në jug i cili vijon me emërtimin bulevardi “Byrrah” në orientimin lindor. Përpara teatrit shtrihet sheshi “Liria” i cili shërben për mbledhjen e vizitorëve e qytetarëve. Kufizohet me struktura të karakterit kryesisht hotelier me 1-3 kate, shërbimi/banimit 5-8 kate si dhe me Xhaminë e madhe e qytetit.

Aktualisht. teatri është një pikë historike, kyçe dhe reference në aspektin urban për qytetaret e Durrësit. Ai u përruar më 8 shkurt 1965 duke u konideruar edhe sot shtruktura e vetme në llojin e tij dhe disponon 3 kate mbi tokë dhe 2 kate nën tokë me kapacitet prej 250 personash. Krahas sallës kryesore teatri ofron edhe ambjente të tjera në funksion të artit. Në katin -2 e specifikuar si zonë arkeologjike nuk parashikohen ndërhyrje, ndërsa në katin -1 ato do të jenë të pjeshme në akset L-P/2-11 dhe B-O/6-11(referuar relacionit). Në katet 0, 1 dhe 2 ndërhyrjet do të konsistojnë në të gjithë sipërfaqen. Aksesit në godinë realizohet me shkallarë nëpërmjet fasadës kryesore të shtrirë në orientimin juglindor.

ASPEKTI FUNKSIONAL

Referuar relacionit arkitektonik, realizimi i projektit do të mbështetet në pikat e poshtë shënuara:

- Parashikohet riorganizimi i hapësirave funksionale
- Rritja e kapacitetit të sallës së teatrit për 360 spektatore
- Krijimi i infrastruktures së PAK (personave me aftësi të kufizuara)
- Dhenia e një identiteti inovativ në fasadën kryesore.



Bazuar në projektin arkitektonik, teatri parashikohet t'i nënshtrohet ndërhyrjeve si më poshtë:

Kati -1 me sip.1639 m² zhvillohet me platforma në kuota të ndryshme, të aksesuara nga shkallet. Sipërfaqja ndërmjet akseve 2-5/B-D do të ndahet me mur në dy hapësira, parashikohet riorganizimi i dy nyjeve higjieno sanitare ekzistuese të fokusuara në skaje të godinës dhe eliminimi i dy korpuseve të shkallëve paralele me njëra tjetrën. Ndërkohë do të ruhen korpuset e shkallëve ndërmjet aksvet 7-8/N-P dhe 5-6/A-C të cilat do të aksesojnë godinën në verikalitet. Nuk është krijuar mundësi aksesit në hapësirën me funksion "magazine" në kuotën -2.60m.

Kati përdhe me sip.1487.8m² do të aksesohet nëpërmjet fasadës ballore ku do të eliminohen muret që janë konsideruar të tepërt duke u zëvendësuar me sipërfaqe xhami. Propozohet gjithashtu eliminimi i sip. me shkallarë në aksent 7/G-J. Dy korpuset e shkallëve b/a të prishura të cilat vijonin nga kati -1 do të rindërtohen në këtë kat ($\pm 0.00m$) duke aksesuar kështu zonën e platesë. Do të shtohen shkallë të hapura spirale përballë hyrjes të cilat do të aksesojnë katin e parë teknik. Ndryshime në prishje dhe rivendosje muraturash të brendshme janë parashikuar në zonen e prapaskenës (akset 1-2/C-N) të zhvilluar me ambjente të njëpasnjëshme të aksesuara nga një korridor linear ndërmjet akseve. Vëme re që me zvogëlimin e dhomës së artistëve do të krijohet mundësinë e hapjes së një dritare në fund të korridorit duke krijuar ajrim e ndriçim natyral. Sipërfaqja ndërmjet akseve 1-2/D-H do të ndahet në dy dhoma për artistet. Do të spostohet dera e nyjes h/s si dhe do të vendoset një derë për aksesin direkt në prapaskenë. Në sipërfaqen e lartpërmendur të artistëve pozicionohen shkallet që do të sigurojnë lëvizjen vertikale në çdo kat duke funksionuar gjithashtu për evakuim në raste emergjente. Nuk kemi të bejmë me një skenë të rrotullueshme por ajo është statike, e aksesuar me shkallë. Sipërfaqja që zë skenën dhe platea me 9 rreshta, përfshirë llozhat me 4 rreshta është 430m² dhe xhepat e skenës janë nga 64m². Zona e muzeut të pallatit të kultures (42.7m²) dhe fond i piktuës (50.7m²) janë përqendruar në anësore të nuklit kryesor të planimetrisë me akses nëpërmjet hyrjes kryesore. Zona e artistëve përqendrohet në orientimin verior me akses nga jashtë.

Kati i parë me sip. 1318.6m² do të pësojë ndërhyrje minimale të cilat konsistojnë në eliminimin e murit ndarës në hapësirat e përbashkëta me qëllim zgjerimin e sipërfaqes përballë korpusit të shkalleve (akset 7-8/L-N) i cili siguron lëvizjen vertikale, prishja e dy mureve në hyrje të llozhave me distancë 16.6m nga aksi 6 si dhe do të riorganizohen nyjet h/s. Zona ku zhvillohet teatri do të arrijë deri në lartësinë h=7.40m në formë ballkonatë. Zona e llozhës/platea dhe ambjentet pritëse do të aksesohen nga shkalla spirale me diameter d=3.60m e propozuar për t'u vendosur e re. Ambjentet e tjera në funksion të artit dhe zyrat e fokusuara në orientimin ballor të godinës (akset 7-10 / A-P) do të aksesohen me korpus shkalle të dedikuar në menyrë që të krijohet ndarje vizuale dhe gjithashtu funksionale me sallën kryesore të teatrit.

Kati i dytë me sip.1318.6 m² do të konisitojë në prishjen e shkallëve të cilët aksesonin zonën e artisteve me zyrën e drejtorit dhe sallën e provave të cilat do të kthehen në ambjent të përbashkët duke funksionuar vetem si sallë provash me akses në “dhomën e inspirimit” e cila do të eleminohet duke funksionuar si garderobë në formë gjatësore me sip. 42.9 m².

Ambjentet e parashikuara në katin nën toke (-2.60m, 2.55, 3.53, 6.50m) janë:

- holli
- zona e gropës së skenës
- zona e impiantistikës
- kabina elektrike
- dhomë lavanderie
- 5 ambjente magazinash
- 2 dhoma e elementeve të ndriçimit

Ambientet e parashikuar në katin përdhe (±0.00m, -0.30m, -0.10m) janë:

- zona e skenes/platea/lloze
- zona e artisteve me 4 dhoma + 1 nyje h/s
- fondi i pikturës
- muzeu i pallatit te kultures
- bar/kafe
- 3 magazina

Ambientet e parashikuara në katin e parë (+2.40m, +3.62m, 4.00m) janë:

- hapësira e skenes nga kati përdhë
- zona e llozhës
- 2 ambjnte pritje + bar
- 2 ambjente në funksin të dekorit të skenës
- 2 hapësira ndihmëse për dimërat
- sallë multifunkionale për 64 persona (sip.77.5m²)
- zyrë marketingu dhe skenografi
- zyrë drejtori+nyje h/s
- protokoli
- zona e pushimit me 5 dhoma fjetje + nyje h/s në sherbim të artistëve
- magazinë
- nyje h/s e përbashkët

Ambientet e parashikuara në katin e dytë (4.90m, 5.90m, 6.25m, 7.10m,7.36m) janë:

- hapësira e skenes
- zona e llozhës
- dhoma e regjise



- garderojë
- ambiente rrobaqesie
- hapësire pritje për artistët
- zonë pushimi me 5 dhoma fjetje + nyje h/s në shërbim të artistëve
- 3 sallë provash
- 3 ambiente zyra
- 2 sallë polivalente (270m² dhe 35m²)
- arkivë
- nyje h/s
- dhomë pastruese

Volumetria e teatrit ruan konturet e tij por parashikon ndërhyrje tjetërsuese në fasaden ballore ku zevendesohen disa prej mureve perimetralë me elemente xhamerie. Fasada ballore do të trajtohet si fasade kinetike pozicionuar mbi kolonadat ekzistuese, e konceptuar në lëvizshmëri me module të kompozuar me elemente dim=20x20cm dhe hapësirë fuge 10cm, në ngjyrë të florinjte. Ky imazh fasade do të aplikohet gjithashtu në orientimet përendim dhe lindje me qëllim identifikimin e vullmeve të cilat do të shërbejnë si salla në funksion të artit (akset 7-10). Në sipërfaqet e tjera të volumetrisë do të aplikohet lyerje me suva grafiatto dhe elemente druri në kolonada e kornizime në dritare. Shkallet e jashtme do të vishen me mermer.

Rifiniturat në interior do të konsistojnë në eliminimin e dyshemeve ekzistuese dhe zevendesimin me: mermer, dru, rezine dhe moket. Tipologjitë e propozuara të ndriçimeve do të konsistojnë në: ndriçimin specifik horisontal në funksion të skenës, ndriçuesat të varur, tavanorë, panele led (60x60cm) të aplikuara në museun e pallatit të kulturës, fondin e pikturës dhe në disa prej zyrave kryesore. Janë parashikuar gjithashtu ndriçuesat led në formë horizontale në sallën polivalente dhe sipërfaqet e përbashkëta të hollit dhe korridoreve (katet 1 dhe 2), ndriçuesat të varur në zonën e pushimit të artisteve si dhe spote.

KONKLUZIONE:

Bazuar në analizën dhe shqyrtimin e projektit të vënë në dispozicion për objektin: "RIKUALIFIKIMI I TEATRIT "ALEKSANDER MOISIU"", arrihet në përfundimin:

Rikualifikimi i Teatrit në qytetin e Durrësit do të ketë impakt pozitiv për qytetaret dhe turistët që do e vizitojnë atë. Ndryshimet e propozuara në projekt, në aspektin funksional të hapësirave të brendshme si dhe të rifiniturave do të risjellin riorganizim të ambienteve me tematikë të ndryshme kushtuar artit si dhe përmirësimin e kushteve të artistëve. Rifiniturat e propozuara janë kontemporane edhe efçente në aspektin energjistik. Aplikimi i materialeve të parashikura në projekt sigurojnë komoditet në aspektin akustik. Megjithatë, projekti arkitektonik i propozuar ka ndryshuar siluetën e godines së Teatrit në faqen ballore të tij duke tjetërsuar pamjen e jashtme të fasadës. Ai e kthen atë në fasade

kinetike me elemente moderne duke mos ruajtuar identitetin fillestar të saj, si pjesë e Zonës Arkeologjike “A”.

- Të paraqitet miratimi i projektit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).

Referuar Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” është ligji baze që përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Të reflektohet në projektin teknik aksi 11, referuar relacionit të vene në dispozicion.
- Referuar relacionit, objekti ka presencë lagështie dhe rënie suvaje. Të paraqiten imazhet ekzistuese si dhe analiza patologjike nga brenda dhe jashtë tij në fasadat ekzistuese për të kuptuar ku qëndrojnë dëmtimet.
- Te krijohet nyje higjeno-sanitare për PAK (personat me aftësi të kufizuara), referuar Vendimit nr.1503, datë 19.11.2008 "rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"

3. PROJEKTI KONSTRUKTIV

2.1 TË DHËNAT STRUKTURE

Për godinën ekzistuese është paraqitur një relacion teknik ku jepet gjendja ekzistuese e godinës, ndërhyrjet që do të realizohen, si dhe specifikime teknike të punimeve.

Gjendja ekzistuese e godines

Pranë grupit të opences është paraqitur objekti: “RIKONSTRUKSION I PALLATIT TË KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU”, në qytetin e Durrësit. Pallati i Kulturës “Aleksandër Moisiu” ndodhet në veri të “Sheshit Liria”, te qytetit të Durrësit. Godina ekzistuese e shkollës është një objekt me 2 mbi toke dhe 2 kate nën tokë.

Gjendja ekzistuese

Aktualisht në objekt, krahas problemeve të ndryshme të tilla si lagështia apo rënia e suvasë kërkohet dhe një riorganizim i hapësirave për një shfrytëzim sa më optimal të objektit.

Objektivi i projektit

Në mënyrë që riaftësimi i strukturës të realizohet konform kërkesave teknike, duhet që gjatë punimeve të zhveshje/pastrimit të evidentohen të gjitha zonat ku ka dëmtime të dukshme.

Ndërhyrjet e parashikuara te objekti janë si më poshtë:

Kolonat në aksin 1, në katin -2 do iu hiqet suvaja, do risuvatohen dhe rilyhen.

Muret te shkalla e aksesit për në katin -2 (zona arkeologjike) do hidroizolohet, dhe risuvatohet.

Vutat do iu hiqet suvaja, do risuvatohen dhe rilyhen.

Shkallët ekzistuese për akses nga kati (-1_0) do spostohen.

Shkallët te holli te hyrja do spostohen.

Shkallët ekzistuese për akses nga kati (0, +1) do mbyllen, do vendoset shkallë e re.

Soleta e hapur ngjitur me shkallët ekzistuese të aksesit nga kati (0-+1) do mbyllet.

Konsoli në katin +1 do të hiqet.

Do merren masa sipas detajit përkatës të projektit, për ripërtëritjen e zonave të degraduara, nga lagështira dhe korrodimi i hekurit.

Do bëhet fuga ndarëse mes objekteve.

Fugë horizontale - në soletën e katit -2 dhe në terracë.

Fugë vertikale - në zonën ndarëse mes objekteve.

Muratura ekzistuese e tullës në zonat e treguara në plane që do të hiqet, të ribëhet me: tulla të lehtësuara, llaç të markave të larta dhe breza horizontalë.

Ndërhyrjet duhet të bëhen me kujdes të veçantë, sepse gjatë punimeve të zhveshjes apo pastrimit mund të shfaqen edhe dëmtime të paparashikuara, sidomos në katet e poshtme. Ndërhyrjet në raste të tilla, të realizohen pas konfirmimit nga mbikëqyrësi, ku për cdo paqartësi duhet të konsultohet edhe projektuesi.

STRUKTURA TË VECANTA QË SHTOHEN (SHKALLA ELIKOIDALE)

Për të realizuar oponencën teknike të projektit konstruktiv të objektit janë vënë në dispozicion materialet teknike të mëposhtme :

- Projekti konstruktiv me ndërrhet e nevojshme
- Relacioni teknik

Strukturë e re që do rindërtohet është një shkallë elikoidale.

Projekti konstruktiv i shoqëruar me Relacionin (22 faqe A4) përkatës është hartuar dhe vulosur nga Ing. Alier Cara.

Nga analizimi i Relacionit Teknik, që shoqëron projektin konstruktiv vërejmë se:

- Projektuesi i referohet normave shqiptare dhe europiane të projektimit për analizimin, llogaritjen dhe dimensionimin e objektit sipas kodeve të mëposhtme:
 - a) Kushti Teknik i Projektimit (KTP)
 - b) Eurocode 0: Basis of structural design EN 1991
 - c) Eurocode 1: Actions on structures EN 1992
 - d) Eurocode 2: Design of concrete structures EN 1993
 - e) Eurocode 8: Design of structures for earthquake resistance EN 1999
 - Programi me të cilin është bërë llogaritja e objektit është SAP2000.
- Përsa i përket të dhënave të projektimit të paraqitura në këtë relacion konstatojmë që:
 - o Klasa e betonit është zgjedhur C20/25 për shkallët që do spostohen; C25/30 për shkallen elikoidale. Kjo klasë plotëson kushtet e paraqitura në EN.1998-1:2004 (5.4.1.1 (1P)) për materialet në elementët primarë sizmik për strukturat e projektuara për klasën e duktilitetit DCM.
 - o Për të gjithë elementët strukturorë armatura e çelikut e zgjedhur është B500B me $f_{yk} \geq 500 \text{MPa}$ me duktilitet të lartë sipas rekomandimeve EN 1992 – 1 – 1.
 - o *Rekomandojmë të paraqiten parametrat e përzgjedhur për spektrin e projektimit.*
 - o Janë paraqitur kombinimet e ngarkesave që veprojnë në objekt. Kombinimet janë marrë konform normave europiane të projektimit.
 - o Në relacion janë paraqitur fragmente të modelimit të strukturës në programin kompjuterik.
 - o *Në relacion duhet të paraqiten rezultate të sforcimeve të marra për elementët strukturorë, si edhe format e lëkundjeve për tre modet e para.*

2.2 PËRSHKRIMI I ELEMENTËT STRUKTURORË

Përpos ndërhyrjeve jo-konstruktive, ato konstruktive evidentohen në këtë pjesë të opionencës. Shtim të strukturave të vecanta si shkalla elikoidale, spostimi i dy shkallëve dhe ndërtimi i tyre, armim i dy soletave të reja janë disa ndërhyrje që për opionentin vlejné për ti gjykuar nga ana konstruktive.

Themelet

Plinti i cili shërben si bazament për shkallën elikoidale është armuar i plotë.

Gjithashtu dhe Trau i themelit me dimensione 30x80 që shërben si mbështetje për shkallën e spostuar është paraqitur përgjithësisht i plotë.

Trarët

Trau është projektuar me strukturë b/a, me përmasa të seksionit tërthor 35x30. Nga kontrollet e kryera për trarët e paraqitur kemi këto rezultate:



- *Gjerësia e trarëve plotëson kushtin EN.1998 (5.4.1.2.1 (3P))*
- *Përpara fazës së zbatimit duhet të plotësohet paraqitja e traut T-7 me kthimin e duhur te shufrave gjatësore.*

Soleta dhe Shkalla

Ne kuoten ± 3.62 janë projektuar dy dysheme monolite 17 cm të cilat janë armuar me zgare $\varnothing 10$. Gjithashtu në katin përdhe në kuotën -0.04 është hedhur një soletë i cili është armuar me zgare $\varnothing 8$ si dhe mbahet një mur butobetoni

- Armimi i dyshemeve është paraqitur përgjithësisht i plotë.
- Konstruimi dhe armimi I rampës së shkallës elikoidale dhe shkallës të spostuara është paraqitur përgjithësisht I plotë.
- *Përpara fazës së zbatimit duhet të plotësohet projekti konstruktiv me paraqitjen e shkallës së dytë të spostuar.*

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME NGA OPONENCA PËR PROJEKTIN KONSTRUKTIV

Godina ekzistuese e shkollës

- Të paraqitet llogaritja e shkallëve që rindërtohen si dhe vendndodhjen e shkallëve të spostuara në plan.
- Rekomandojmë të merret parasysh në llogaritjen e shkallëve elikoidale plinti në të cilin mbështeten këto shkallë.
- Përpara fazës së zbatimit duhet të plotësohet projekti konstruktiv me paraqitjen e shkallës së dytë të spostuar.
- Të shtohet në projektin konstruktiv përdorimi i markës së betonit C25/30 për shkallen elikoidale e cila sipas relacionit teknik është realizuar me këtë markë betoni.
- Të përcaktohet ca marke betoni përdoret për realizimin e soletave.
- Tipet e ndryshme të riparimeve janë jo vetëm në elementë strukturorë, por edhe në elementë jo-strukturorë. Gjithsesi, kjo nuk e heq zbatuesin e punimeve nga përgjegjësia për të shikuar me vëmendje nëse gjatë punimeve të zhveshjes së suvasë dhe pastrimit, shikon plasaritje të thella e serioze që vazhdojnë edhe nëpër elementë strukturorë.
- Duhet të zbatohet me kujdes, hap-pas-hapi riparimi i dëmeve, sipas specifikimeve të relacionit teknik.
- Nëse gjatë punimeve të riparimit, haset vështirësi apo paqartësi, duhet konsultuar projektuesi.
- Ndërhyrjet duhet të bëhen me kujdes të veçantë, sepse gjatë punimeve të zhveshjes apo pastrimit mund të shfaqen edhe dëmtime të paparashikuara, sidomos në katet e poshtme. Ndërhyrjet në raste të tilla, të realizohen pas konfirmimit nga mbikëqyrësi, ku për cdo paqartësi duhet të konsultohet edhe projektuesi.

- Kontraktori, përpos zgjidhjeve teknike të dhëna në projekt, duhet të konsultohet me mbikëqyrësin e punimeve për trajtimin e dëmtimeve të zbuluara gjatë fazës së punimeve të zbatimit.
- Detaje tipe të lëna në projekt, të përdoren vetëm nqs do ketë raste të tilla, pas punimeve të zhveshjes të suvasë.
- Sasia e armaturës, armimi i secilit element në vecanti dhe përmasat e prerjeve tërthore të elementeve strukturore mbeten përgjegjesi e konstruktorit të objektit.

4. PROJEKTI ELEKTRIK

Per objektin: Teatri qytetit Dures

Projekti eshte realizuar nga Ing. El. Orion Zavalani dhe Ing. El. Gjergj Dashi.

Mungon Licenca ose fotokopja e Licences e noterizuar e projektuesit elektrik.

Projekti elektrik permban:

1. Sistemi prizave te fuqise katet: -1, 0, 1, 2
2. Sistemi ndricimit katet: -1, 0, 1, 2
3. Sistemi ndricimit emergjent katet: -1, 0, 1, 2
4. Sistemi zbulimit dhe lajmerimit te zjarrit katet: -1, 0, 1, 2
5. Sistemi rrjetit LAN, CCTV dhe fonise katet: -1, 0, 1, 2
6. Instalimi kanalave metalike katet: -1, 0, 1, 2
7. Furnizimi me energji i sistemit HVAC katet: -1, 0, 1, 2
8. Furnizimi me energji i sistemit HVAC tarace
9. Skema principale e furnizimit me energji elektrike
Skema principale e kuadrit HVAC
Skema principale e sinjalistikes dhe ndricimit emergjent
10. Skema principale e ndricimit skemes
11. Skema principale e sistemit CCTV
Skema principale e sistemit zbulimit dhe lajmerimit zjarrit
Skema principale e ventilimit
12. Skema e sistemeve te salles
13. Detaje elektrike

Nga analiza e relacionit teknik te paraqitur konstatoj:

Furnizimi me energji elektrike i objektit do te realizohet me nje transformator 250kVA dhe nje gjenerator 250 kVA per rastet e mungeses se furnizimit nga rrjeti.

Per te rritur sigurine e furnizimit me energji elektrike te objektit te Teatrit jane parashikuar 2 linja ne tension te mesem 20 kV qe duhet te mundesohet nga OSHE.

Pajisjet duhet te jenë produkti standard i fundit i prodhuesit.



Ngarkesa elektrike e objektit është $S = 600$ kVA.

Ne relacion thuhet se koncepti përgjithshëm i instalimeve është i bazuar sipas standarteve shqiptare, standarteve EN dhe në disa raste me rregullat DIN.

Sistemi i tokezimit:

Sistem TNC-S për Panelin kryesor të godines

Sistem TNS për nënpanelet Tensionin nominal Punes

Celat e TM që do të furnizohen dhe instalohen do të jenë të parafabrikuara dhe me module, të jenë të thjeshta në instalim, të sigurta dhe funksionale, të testuara paraprakisht në fabrike.

Celat do të jenë me ndares me ajër hark-shuars të tipit SF6 dhe rele me mikroprocesor. Ato janë dy tipesh,

Tipi i parë për komutimin e linjes hyres dhe dalese, dhe tipi dytë për mbrojtjen e transformatoreve në tension të mesëm.

Celësi Automat SF6 duhet të jetë i tipit me mirëmbajtje minimale. SF6 përdoret si gaz shuars dhe izolues

me një presion të ulët të matjes prej 0.15 MPa, pra 1,5 bar.

Lartësia maksimale e paneleve të celave nuk do të kalojnë 2000 mm.

Kabllo të TM duhet të plotësojnë kërkesat për llojin e izolimit, veshjes dhe të përcjellesve sipas standardit dhe kërkesave të projektit. Kabllo të prodhuar më shumë se 12 muaj para datës të dorëzimit nuk do të pranohen.

Në rastet e mungesës së furnizimit nga OSHEE vazhdimësia e punës do të sigurohet nëpërmjet gjeneratorit diesel, fuqia e të cilit është llogaritur gjatë zhvillimit të projektit. Ai do të jetë i tipit silencioz me nivel zhurme deri 65 db dhe me komutim automatik të integruar me kuadrot e ambienteve të përbashkëta.

Në panelin e gjeneratorit të raportohen edhe rastet e alarmit, për defektet e mundshme të grupit elektromotor, për nivelin e naftës në serbator, etj.

Gjeneratori dhe pajisja e komutimit automatik duhet të kenë një dalje komunikimi ModBus për tu lidhur me sistemin BMS të objektit.

Të gjithë kabllo apo përcjellesit që do të përdoren do të jenë fleksibel, tipike për ambiente rezidenciale. Në parkim do të përdoren kablo dhe përcjelles të izoluar me një material që siguron mbrojtjen e tyre në rast të rrezikut të rënies së zjarrit, referuar normës IEC332.3 mbi kriteret e kërkuara, duke limituar shpërndarjen e avujve halogjen dhe gazrave toksike ose të tymrave në ambient.

Kabllo të kalojnë në kanalina ose tuba PVC. Instalimi në kanaline ose brenda tubave të realizohet sipas seksionit duke iu referuar rekomandimeve të prodhuesit.

Kuadri tensionit të ulët është metalik me derë xhami dhe zbarra bakri sipas rekomandimeve të prodhuesve dhe kërkesave teknike, për një instalim korrekt. Kuadri do të përmbajë automatet magnetotermike dhe diferenciale. Kuadri tokezohe me sistemin e tokëzimit të kabines.

Automatet e instaluar në kuadrin e TU në kabine duhet të kenë një strukturë solide dhe të jenë të

tarueshem ne baze te ngarkeses dhe selektivitetit si per mbrojtjen magneto termike edhe per ate diferenciale.

Ne projekt jane parashikuar:

- Rrjeti i shperndarjes se fuqise
- Rrjeti i ndricimit normal dhe te emergjences
- Rrjeti LAN, telefoni
- Impianti i detektimit te zjarrit
- Sistemi i kamerave
- Sistemi HVAC

Sugjerorj te paraqiten:

- Sistemi rrufeprites
- Sistemi i tokezimit
- Te sigurohet furnizimi me linje te vecante i stacionit te pompave kunder renies se zjarrit.

Konkluzion: Mendoj qe projekti i dhene plotesohet me sugjerimet e bera.

5. PROJEKTI HIDROSANITAR

OBJEKTI:“RIKONSTRUKSION PALLATI KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU DURRËS”

TË PËRGJITHSHME

Oponenca teknike për projektin e zbatimit të objektit : “RIKONSTRUKSION PALLATI KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU DURRËS” është bërë duke u mbështetur në materialet e mëposhtme të Projekt Zbatimit:

Projekti i Zbatimit përmban:

- **Relacion Teknik**
- **Projekt Zbatimi**
- **Specifikime Teknike**
- **Preventivi i Punimeve**

❖ **SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË**

Në relacionin teknik si dhe në vizatimet teknike është dhënë metodologjia e sistemit të furnizimit me ujë. Sistemi i furnizimit parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidro-sanitare me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë si dhe për të siguruar rezervën e mbrojtjes nga zjarri.Në relacion teknik shprehet se furnizimi me ujë të ngrohtë do të realizohet me boiler elektrik. Furnizimi me ujë

sanitar i objektit “Rikonstrukcion Pallati Kulturës Aleksandër Moisiu Durrës” është parashikuar të bëhet nga rrjeti i furnizimit me ujë i qendrës së banuar. Tubacioni kryesor i cili bën furnizimin me ujë të ndërtesës është parashikuar PE 100 Dj 63mm. Më pas nga kolektorët nëpër nyjet hidrosanitare shpërndarja e ujit do të bëhet me anën të tubave PEX-AL. Është përshkruar ambjenti teknik me të gjithë elementët përbërës si në relacion ashtu dhe në materialet grafike.

Duke patur parasysh Raportin Teknik si dhe vizatimet grafike Oponenca vëren:

- Skema e furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë është përshkruar në relacion teknik .
- Furnizimi i brendshëm i nyjeve sanitare është paraqitur në planimetrinë e secilit kat si dhe janë dhënë lloji dhe dimensionet e tubacioneve.
- Në projekt jepet skema aksnometrike e linjës së furnizimit me ujë.
- Në materialet grafike është paraqitur ambjenti teknik si dhe karakteristikat teknike të të gjitha paisjeve që shërbejnë për funksionimin e plotë të skemës së furnizimit me ujë.
- Në relacion janë paraqitur llogaritjet hidraulike për sistemin e furnizimit me ujë .

Konkluzion:

Oponenca mendon se projekti i furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë sanitar i objektit : “Rikonstrukcion Pallati Kulturës Aleksandër Moisiu Durrës „ është hartuar në përgjithësi drejt në përputhje me kushtet teknike që janë në fuqi apo KTP në vendin tonë si dhe normave dhe standarteve europiane për llogaritjen dhe projektimin e këtyre sistemeve në godinë.

❖ SISTEMI I KANALIZIMIT

RRJETI I BRENDSHËM DHE I JASHTËM I UJRAVE TË ZEZA DHE TË BARDHA

Në relacion teknik jepet metodologjia e sistemit të kanalizimit ujrave të zeza dhe ujrave të shiut. Sistemi i kanalizimit të brendshëm dhe të jashtëm është projektuar në përputhje me projektin arkitektonik të objektit :“ Rikonstrukcion Pallati Kulturës Aleksandër Moisiu Durrës” . Sistemi i shkarkimeve të ujrave të zeza bëhet me gravitet deri në lidhjen me rrjetin publik të shkarkimit të ujrave të zeza. Sistemi është dimensionuar në mënyrë të tillë që ujrata e shkarkuara të mos okupojnë të gjithë seksionin e tubacioneve të shkarkimit. Rrjeti i kanalizimit është paraqitur për secilin kat të objektit në planimetri brenda nyjeve sanitare. Sipas përshkrimit në raport teknik për impjantin e shkarkimit të ujrave të zeza brenda nyjeve sanitare janë përdorur tubacione PP. Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut është i përbërë nga rrjeti i mbledhjes së ujrave të tarracës dhe nga rrjeti i drenazhimit të ujrave sipërfaqësor të territorit të pallatit të kulturës. Ujrata e shiut nëpërmjet pjerrësive që do ti jepen strukturës kalojnë nëpër piletat që janë përcaktuar të vendosen në planin e tarracës. Dhe më pas largohen me anë të kollonave vertikale dhe përfundojnë në rrjetin e jashtëm të pusetave të shiut nëpërmjet kalime horizontale në tavanin e katit nëntokë.

Duke patur parasysh Raportin Teknik si dhe Vizatimet grafike për këtë instalim Oponenca mendon se :

- Rrjeti i brendshëm dhe i jashtëm i kanalizimit të ujrave të zeza bëhet i ri sipas të dhënave në relacion teknik.
- Në materialet grafike jepet planimetria e shkarkimit të ujrave të ndotura si dhe janë dhënë llojet dhe dimensionet e tubacioneve.
- Në projekt janë paraqiten skemat aksonometrike si dhe kollona e ventilimit të nyjeve sanitare.
- Në materialet grafike është paraqitur plani i sistemit të ujrave të shiut në ambjentet e jashtme.
- Llogaritjet hidraulike për sistemin e shkarkimit të ujrave të ndotura si dhe të ujrave të shiut janë paraqitur në relacionin teknik.

Konkluzion:

Oponenca mendon se projekti i kanalizimit të ujrave të zeza (të brendshme dhe të jashtme), si dhe ai ujrave të bardha (të shiut) është hartuar në përgjithësi në përputhje me kushtet teknike të projektimit KTP që janë në fuqi në vendin tonë dhe ato europiane të projektimit të këtyre sistemeve.

❖ SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

Projekti përfshin ndërtimin e rrjetit hidrik të mbrojtjes nga zjarri si dhe pajisjet që do të përdoren në të. Raporti teknik si dhe vizatimet grafike janë paraqitur të plota për këtë sistem. Të gjitha sistemet në këtë objekt do të bëhen të reja. Llogaritjet për sistemin e Mbrojtjes Ndaj Zjarrit duke marrë në konsideratë edhe karakteristikat e ndërtesës si dhe destinacionin e saj, janë përdorur substanca shuarëse si :

- nje rrjet stacionar i hidrantëve të jashtme;

- sistem i mbrojtjes nga zjarri me ujë, me hidrante të brendshëm në të gjitha katet e godinës;

- shuarës portabel në të gjitha pozicionet e treguara në projekt.

Katër hidrante të jashtëm UNI 70 janë pozicionuar për qark godinës dhe furnizohen me ujë nga nje rrjet nëntokësor HDPE. Në tre katet e godinës janë vendosur hidrante të brendshëm UNI 25, të pajisur me tubacion "fleksibel".

Kasetat e hidrantëve të brendshëm janë vendosur në pozicion të dukshëm dhe të pajisur me sinjalistikën përkatëse. Lëshuesi dhe tubacioni i ujit janë vazhdimisht të lidhura me kolonat e furnizimit me ujë. Sasia e ujit që kërkohet është barabartë me kërkesat për ujë të vazhdueshëm për shuarjen e zjarrit si dhe kohën në dispozicion që duhet për eliminimin e tij. Kjo sasi përcakton depozitën e nevojshme të ujit në dispozicion për mbrojtjen nga zjarr për një autonomi mbi 60 minuta të impjantit MNZ sipas llogaritjeve 40 m³ në dispozicion të impjantit. Rezervuari MNZ do të jete me seksione, për të mundësuar futjen në godinën ekzistuese dhe duhet të pajiset me tregues nivel elektronik si edhe mekanik vizual, Grupi i pompimit të impjantit kundër zjarrit do të vendoset në ambjentin teknik, në katin -2, në të njëjtin nivel me depozitën e ujit MNZ. Ky grup do të jetë në përputhje me normativen EN 12845 dhe do të përbëhet nga 1 pompë pilotë, 1

elektropompë shërbimi si edhe motopompa e shërbimit. Në projekt janë përcaktuar me saktësi edhe zonat që kane lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku janë vendosur fikësit portabël të zjarrit.

Fikësit e zjarrit portabël me pluhur EN3 do të jenë të klasës 34A 233BC.

Oponenca vëren se :

- Raporti Teknik i paraqitur është përqëndruar kryesisht tek mbrojtja me ujë si dhe përshkruan pjesët e tjera përbërëse të Sistemit të Mbrojtjes nga Zjarri. Nga projektuesi për hartimin e projektit është patur parasysh dhe është përdorur në mënyrë korrekte jo vetëm ligji mbi "Rregulloren e Projektimit në ndërtesat e cdo lloji" por janë marrë parasysh edhe standartet e ngjashme si UNI 10779, EN12845, UNI9490, UNI671-1 apo kushtet teknike shqiptare. Nga projektuesi është paraqitur projektet i MNZ për të gjithë objektin.

Duke u nisur nga "Rregullorja mbi masat mbrojtëse kundra zjarrit në projektimin e ndërtesave të cdo lloji " si dhe nga vetë funksionimi i objektit me kërkesa të vecantë për mbrojtjen nga zjarri janë përcaktuar drejt :

- Është trajtuar drejt dhe në favor të mbrojtjes kundra zjarrit, struktura e objektit, qëndrueshmëria e tij faktike dhe ajo e kërkuar në bazë të normave të MNZ etj. Materialet e përdorura në strukturë në bazë të qëndrueshmërisë REI
- Në projekt paraqitet plani i evakuimi të personave që mund të ndodhen në godinë në rast zjarri i cili duhet të shoqërohet me fletë vizatimi
- Sistemi i furnizimit me ujë i hidrantit të zjarrit është një sistem i rëndësishëm për godinat , i cili projektohet duke u bazuar jo vetem në projektin arkitektonik por edhe në kriteret minimale të dhëna nga rregullorja e PMNZSH-së.
- Nuk është paraqitur pozicioni i godinës në lidhje me godinat përreth, rrugët e lira të kalimit të automjeteve zjarrfikës, dhe afrimi i tyre pranë me lehtësi pranë objektit, dyer dritare, kalimet e emergjencës etj .
- Në relacion teknik janë dhënë llogaritjet hidraulike për sistemin e mbrojtjes ndaj zjarrit.
- Në materialet grafike është paraqitur ambjenti teknik me pajisjet që shërbejnë për funksionimin e këtij sistemi.

Konkluzion :

Oponenca mendon se projekti për Mbrojtjen nga Zjarri i objektit "Rikonstruksion Pallati Kulturës Aleksandër Moisiu Durrës ,, është hartuar në përgjithësi drejt në përputhje me normat dhe standartet europiane si dhe rregulloren e PMNZSH-së për hartimin dhe paraqitjen e këtyre projekteve.

❖ SISTEMI I NGROHJES-FTOHJES

Projekti i ajrit të kondicionuar të objektit “Rikonstruksion Pallati Kulturës “Aleksandër Moisiu”, Durrës është mbështetur në të dhënat klimatike për qytetin e Durrësit, në normativat projektuese për ambiente të ngjashme si dhe Direktivat e Komitetit Evropian: si direktiva 93/76 CEE e Këshillit të Europës. Përshkrimi në relacion teknik ka të bëjë me furnizimin, shpërndarjen, testimin, balancimin dhe vënien në funksionim të ajrit të kondicionuar si një i tërë në këtë objekt.

Të gjitha ambientet e godinës do të shërbehen nga impjante të ajrit të kondicionuar të tipit VRF. Për ambientet me prezencë të konsiderueshme personash sistemi do të kombinohet me "Rikuperim Energjie" duke mundësuar ventilimin e këtyre ambienteve si dhe zëvendësimin e ajrit. Për ambientet e tjera si zyra , dhoma artistësh, garderobera do të aplikohen pajisje ngrohje ftohje vertikale në dysheme.

Pajisjet e jashtme të impjanteve VRF do të jenë të tipit monoblok dhe do të përfshijnë të paktën një kompresor Scroll të tipit Linear Inverter me bande të ndryshimit të frekuencës (30Hz - 115Hz), duke mundësuar në këtë mënyrë rregullimin e shpejtësisë dhe sasisë së fluidit në përputhje me kërkesat për ngrohje/ftohje. Në ambientet e skenës si edhe në të gjitha ambientet sanitare të godinës është aplikuar ngrohja me radiator. Salla Polivalente në katin e dytë kondicionohet nëpërmjet një sistemi “gjithë ajër” ku ajri i kondicionuar sigurohet nga një "Central Trajtimi Ajri" i vendosur në tarracën e objektit.

Për projektin e paraqitur opoenca vëren:

1. Projekti paraqitet i plotë dhe i konceptuar drejt nga projektuesi.
2. Metodologjia e llogaritjes se humbjeve termike është e saktë .

Konkluzion:

Oponenca mendon se projekti i ngrohje – ftohjes dhe ventilimit të objektit : “Rikonstruksion Pallati Kulturës Aleksandër Moisiu Durrës” është projektuar drejt sipas standarteve dhe normave që janë në fuqi në vendin tonë dhe ato europiane të projektimit për këto sisteme.

6. SPECIFIKIME TEKNIKE

Specifikimet teknike të objektit: **“RIKONSTRUKSIONI PALLATIT TË KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS**, janë paraqitur në 40 fq A4 hartuar dhe firmosur nga Ing. Alier Cara me Nr. Lic. K.1221/2 si dhe ne 12 faqe specifikimet arkitektonike, firmosur nga Ark. Ani Tola. Në to janë paraqitur kapitujt e mëposhtëm:

- *Specifikime të përgjithshme*
- *Punime prishjeje dhe pastrimi*
- *Punime dheu, gërmime dhe themelet*
- *Punime betoni, armimi dhe hekuri*



- *Elementët e tjerë të ndërtimit (Muret, ndarjet, mbulesat dhe strukturat metalike)*
- *Rifiniturat*

Gjithashtu janë paraqitur specifikime të ilustruara me foto në një raport prej 12 fq A4. Janë paraqitur specifikimet si më poshtë:

- *Rifinitura të dyshemesë, mureve dhe tavaneve*
- *Specifikime të ndricimit*
- *Specifikime të dyerve dhe dritareve*
- *Specifikime të pajisjeve hidrosanitare*
- *Punime të vecanta*

Konkluzion:

Specifikimet teknike janë përgjithësisht të plota, të plotësohen edhe me specifikimet e MNZ, Elektrike, Hidrosanitare, Impantet e ajrit dhe kondicionimit të cilat paraqiten në preventiv.

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventiv i objektit: “**RIKONSTRUKSIONI PALLATIT TË KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU**”, **DURRËS**, është paraqitur në 37fq A4, firmosur me vule elektronike nga Ark. Ani Tola.

Nga shqyrtimi i këtij preventivi, vërehet se:

- Vlera Totale e preventivit është **595,529,186.98 lekë me TVSH**. Në këtë vlerë përfshihet vlera e fondit rezervë 5 % dhe Tvsh 20%.

Konkluzion:

- **Vlera e preventivave të punimeve të vecanta nuk përkojnë me totalin e punimeve në preventivin përmbledhës. Të rishikohen.**
- **Në preventiv, zërat e punimeve janë paraqitur sipas Manualit Teknik të Cmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre përcaktuar në VKM.Nr. 629, dt.15.07.2015 .**
- **Rekomandojmë që cmimet në preventiv të paraqiten duke i marrë në mënyrë elektronike, sipas përcaktimeve të platformes e-albania, konform VKM në fuqi me Nr.216, datë.13.04.2023.**
- **Zërat e paraqitura si An nuk janë të analizuara. Të plotësohet**
- **Përgjegjësia e volumeve dhe cmimeve të marra në preventiv është e preventivuesit.**

PËRFUNDIM

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin e lejes së ndërtimit të objektit :
“RIKONSTRUKSIONI PALLATIT TË KULTURËS ALEKSANDËR MOISIU”,
DURRËS, me porositës Bashkia Durrës konkludohet se: **Projekti i paraqitur është konceptuar drejt, konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike të plotësohen gjatë zbatimit të punimeve.**



GRUPI I OPONENCËS

Ing. Konstruktor. Hamza KAZIA

Nr.Liç.K.1039/3

Ark. Matilda HAZIZAJ

Nr.Lic.A. 1533/1

Ing. Hidroteknik. Mamica SHEHI

Nr.Lic. H/T.0206/3

Ing. Elektrik. Myzejen MENKULAZI

Nr.Lic.EZ.0783

SPECIALIST NDIHMËS

Ing. Konstruktor. Jozefina STERKAJ

Ing. Hidroteknik. Ina SHENA

Nr.Lic. K.2695

SHEFE E SEKTORIT TË OPONENCAVE

Ing. Mamica SHEHI

DREJTORE DREJTORIE

Ing.Valbona PONDE